



Katalogu i përshkrimit të lëndëve

Master Shkencor në “Menaxhim”

- ***me profilizim në Arsim***
- ***me profilizim në Biznes***

(qershor, 2021)

NEHEMIAH GATEWAY ALBANIA

Rruga “Nehemia”
7304 Bucimas
Albania

Tabela e Përmbajtjes

Moduli A: Orientim karriere dhe për kërkim shkencor	2
1. Lidership & Menaxhim.....	2
2. Kërkim Shkencor & Shkrim Akademik	4
3. Metodatat e Kërkimit Shkencor	6
Moduli B: Drejtim & Menaxhim	8
1. Komunikim Organizativ	8
2. Etika Profesionale.....	10
3. Burimet Njerëzore	12
4. Menaxhimi i Ndryshimeve.....	14
5. Menaxhim Strategjik.....	16
6. Sjellje Organizative	20
7. Planifikim & Financë	22
8. Qeverisje & Zhvillim Organizativ	24
Moduli C: Efektiviteti Organizativ.....	26
1. Menaxhim i Cilësisë	26
2. Menaxhimi i Performancës.....	28
Moduli D: Specializim	30
D.1. Në arsim	30
1. Psikologji Edukative.....	30
2. Mësimdhënia & të nxëniet	32
3. Zhvillimi i kurrikulës.....	34
4. Vlerësimi i studentëve	36
5. Çështjet ligjore në arsim.....	38
6. Përfshirja pedagogjike	40
D.2 Në biznes.....	42
1. Sipërmarrje	42
2. Menaxhimi i Riskut.....	44
3. Kontabilitet & Kontroll	46
4. Çështjet ligjore në fushën e biznesit	48
5. Marketing	50
6. Menaxhim i Operacioneve.....	52
Moduli E: Detyrimet përmbyllëse	54
1. Praktika	54
2. Tema e Masterit	56

Moduli A: Orientim karriere dhe për kërkim shkencor

1. Lidership & Menaxhim

Kodi	Lloji i lëndës	Semestri	Orët e kontaktit	Orët e vetë-studimit	Orët totale	Kredite (ECTS)
L ^{oo}	E detyrueshme	I / III	50	100	150	5
Lektor			Dr. Roy Atwood			
Gjuha			anglisht / shqip			
Qëllimi i lëndës Kjo lëndë ofron një përmbledhje të teorive, kërkimeve dhe praktikave më të mira në lidership dhe menaxhim organizativ. Ajo i prezanton studentët me njohuritë, aftësitë, praktikat më të mira dhe kërkimin e nevojshëm për të drejtuar në mënyrë efektive në pozicione të ndryshme drejtuese brenda një sërë organizatash (biznes, arsim, jo-fitimprurëse, etj.). Studentët do të praktikojnë aftësi kërkimore, vlerësimi dhe menaxheriale që do t'u mundësojnë atyre të jenë drejtues dhe komunikues efektivë organizativ dhe grupi. Studentët do të marrin pjesë në raste studimore, aktivitetet e vlerësimit dhe do të përdorin informacionin e kërkimit dhe rezultateve për të çuar drejt qëllimeve strategjike dhe për të përmirësuar organizatën, grupin dhe veten e tyre në mënyrë profesionale.						
Rezultatet e të nxënit Në fund të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none">• Shpjegojnë dhe vlerësojnë modele të ndryshme të lidershipit dhe menaxhimit• Krahasojnë teoritë aktuale të lidershipit dhe zbatojnë ato në mënyrë të përshtatshme në mjediset profesionale• Njohin dhe vlerësojnë strategjitë e lidershipit• Analizojnë aftësitë dhe prirjet që kërkohen nga drejtuesit dhe menaxherët si dhe marrëdhëniet e tyre të ndërsjella• Identifikojnë dhe përshkruajnë qasjet e vlerësimit dhe përshkruajnë kriteret e përshtatshme organizative• Reflekojnë mbi konceptet dhe rolet e vlerësimit brenda institucioneve dhe pikat e forta dhe të dobëta të tyre• Shpjegojnë dhe kritikojnë një sërë modelesh të lidershipit dhe menaxhimit në organizata të ndryshme• Mbrojnë në mënyrë efektive kërkesat ligjore dhe etike për grupet dhe organizatat drejtuese• Kuptojnë dhe zbatojnë parimet etike në mënyrë të përshtatshme në marrëdhëniet komplekse dhe situatat organizative me punonjësit, institucionet dhe grupet e ndryshme të komunitetit dhe publikut• Identifikojnë dhe vlerësojnë stilet dhe praktikat dominuese të lidershipit organizativ.						
Parakusht(e)		Jo				
LITERATURA						

Kërkohet:

Grint, K. (2010). *Leadership: A very short introduction*. Oxford, UK: Oxford University Press.

Marquet, L.D. (2020). *Leadership Is Language: The Hidden Power of What You Say & What You Don't*. New York, USA: Portfolio/Penguin

Soyer, E. & Hogarth, R. (2020). *The Myth of Experience: Why We Learn the Wrong Lessons, and Ways to Correct Them*. New York, USA: Public Affairs

Rekomandohet:

Institute, T. A. (2010). *Leadership and Self-Deception: Getting out of the Box Expanded*. Williston, VT, USA: Berrett-Koehler.

Fullan, M. (2005). *Leadership & sustainability: System thinkers in action*. Thousand, Oaks, CA: Corwin.

Fullan, M. G. (2016). *The new meaning of educational change*. New York: Teachers College Press.

Hollmann, S. (2013). *Sustainable Leadership: Modellentwicklung, empirische Überprüfung und Gestaltungshinweise*. Wiesbaden: Springer Gabler.

Maxwell, J.C. (2007). *The 21 Irrefutable Laws of Leadership (10th Anniversary edition)*. New York USA: Harper Collins

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Kombinimi i diskutimit të seminarit, metodës sokratike, diskutimit, pjesëmarrjes aktive, prezantimeve, rasteve studimore, vlerësimi të kërkimit aktual dhe një projekti kërkimor. Çdo student pritët të vijë në klasë pasi të ketë lexuar materialin e caktuar, i përgatitur për të diskutuar dhe ndërvepruar në mënyrë kritike me leximet dhe për të kontribuar në lëndë në mënyrë konceptuale, me aftësi, efektive dhe vlerësuese.

VLERËSIMI

Studime gjatë lëndës	Sasia	Përqindja e notës finale
Përgatitje për seminare duke iu referuar prezantimeve	2	20 %
Kuiz / Test		
Rast studimi dhe dokumenta vlerësuese	2	40 %
Ese		
Punë laborator		
Detyra përfundimtare	1	30 %
Pjesëmarrje në leksion		10 %
Përqindja totale / Nota		100 %

2. Kërkim Shkencor & Shkrim Akademik

Kodi	Lloji i lëndës	Semestri	Orët e kontaktit	Orët e vetë-studimit	Orët totale	Kredite (ECTS)
L ^{oo}	E detyrueshme	II / IV	50	100	150	5
Lektori			Prof. Dr. Bardhyl Musai			
Gjuha			anglisht / shqip			
<p>Qëllimi i lëndës</p> <p>Lënda e të shkruarit dhe retorikës kombinon strategjitë e të shkruarit dhe të lexuarit me leximet e librave universitare nga disa disiplina për t'i ndihmuar studentët të kenë sukses në të gjithë kurrikulën e lëndës. Ky kombinim i dobishëm i leximeve dhe manualit u mundëson studentëve fleksibilitet të madh në të mësuar. Përveç leximeve të shumta akademike, kjo lëndë përfshin gjithashtu një aparat thelbësor udhëzimesh dhe ushtrimesh të detajuara, teknika për dëgjim aktiv dhe marrje shënimesh, pyetje me përgjigje të shkurtra dhe teste që angazhojnë aftësitë e të menduarit kritik të studentëve. Ajo thekson veçanërisht vetëvlerësimin si një mënyrë për të zhvilluar zakone të mira të të lexuarit. Kjo lëndë përfshin gjithashtu mundësi të shpeshta të shkruarit dhe kërkon që studentët të shkruajnë të paktën një paragraf përpara se të plotësojnë tekstin.</p>						
<p>Rezultatet e të nxënës</p> <p>Pas përfundimit me sukses të kësaj lënde, studentët duhet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kenë mendim kritik mbi materialet dhe ndjekin udhëzimet e detyrave. • Ndjekin prezantimet akademike në formatet me shkrim dhe me gojë. • Përdorin internetin për të gjetur materiale akademike, përmes bibliotekës. • Demonstrjnë aftësi argumentuese dhe të të menduarit kritik si me shkrim ashtu edhe me gojë. • Punojnë së bashku në grupe dhe në mënyrë jo-formale, diskutojnë punën dhe ndërveprojnë me studentët e tjerë. • Praktikojnë integritetin akademik si një pjesë thelbësore të studimit të tyre. • Demonstrjnë dhe zbatojnë njohuritë e strukturës së esesë, duke përfshirë hyrjen, trupin (pëmbajtjen) dhe mbylljen. • Përdorin faza të ndryshme të procesit të të shkruarit, duke përfshirë parashkrimin, shkrimin dhe rishkrimin. • Demonstrjnë aftësi për të shkruar për një audiencë akademike. • Prezantojnë, pozicionojnë dhe integrojnë materialin burimor në trupin e një eseje. • Përdorin saktë sisteme të ndryshme referimi dhe citimi, duke përfshirë kllapat, citimet në tekst dhe faqet e cituara nga librat. 						
Parakushte(t)		Jo				
<p>LITERATURA Kërkohet:</p>						

Lewis, J. (2005). Studimi akademik. Tiranë: Qendra për Arsim Demokratik (CDE).

McMillan, K., & Weyers, J. (2014). Si të shkruajme një ese dhe detyra universitare. Tiranë: CDE.

Rekomandohet:

Kane, T. S. (2010). Si të shkruajmë shqip: Manual i Oksfordit për të shkruarin dhe retorikën. Tiranë: CDE.

Kane, T. S., & Ogden, K. C. (2008). The Canadian Oxford guide to writing: A rhetoric and handbook. Toronto: Oxford University Press.

Lewis, J. (2007). Academic literacy: Readings and strategies. Boston: Houghton Mifflin.

McMillan, K., & Weyers, J. D. (2011). How to write essays & assignments. Harlow: Pearson Education.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Kombinim i leksionit, diskutimit, pjesëmarrjes aktive, prezantimeve, rasteve studimore, shkrimit të paragrafëve dhe eseve/detyrave. Kjo lëndë do të përfshijë një kombinim të leksioneve, diskutimeve, pjesëmarrjes aktive, studimeve të rasteve, punës në grupe të vogla dhe detyrës përfundimtare. Secili student do të inkurajohet të vijë në klasë i përgatitur për të mësuar, diskutuar, shprehur pikëpamjet e tij.

VLERËSIMI

Studime gjatë lëndës	Sasia	Përqindja e notës finale
Përgatitje për seminare duke iu referuar prezantimeve		
Kuiz / Test		
Reflektime kritike në detyrat e rasteve studimore		
Ese	2	40%
Punë laborator		
Detyra përfundimtare	1	40 %
Pjesëmarrje në leksion		20 %
Përqindja totale / Nota		100 %

3. Metodatat e Kërkimit Shkencor

Kodi	Lloji i lëndës	Semestri	Orët e kontaktit	Orët e vetë-studimit	Orët totale	Kredite (ECTS)
L ^{oo}	E detyrueshme	I / III	50	100	150	5
Lektori			Dr. rer. nat. Nikolai Bunzmann / Dr. Peter Makiriyado			
Gjuha			anglisht			
Qëllimi i lëndës						
<p>Qëllimi i lëndës është të krijojë ose avancojë të kuptuarit e natyrës dhe rëndësisë së kërkimit shkencor. Në mënyrë që të vendoset një bazë për kërkimin empirik, lënda do të mbulojë një sërë metodash në kërkimin arsimor, duke përfshirë qasjet sasiore dhe cilësore. Do të trajtohen fazat dhe elementet e ndryshme të procesit të kërkimit dhe sfidat e qasjeve të ndryshme. Për më tepër, lënda ofron mundësinë për të lexuar kërkime të publikuara, për të interpretuar të dhënat dhe për të vlerësuar rezultatet e studimit. Lënda ofron një mbështetje strukturore si për një rishikim kritik të literaturës në këtë fushë, ashtu edhe për të shkruar një punim kërkimor.</p>						
Rezultatet e të mësuarit						
<p>Në fund të lëndës studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njohin karakteristikat kryesore të kërkimit sasior dhe cilësor. • Kuptojnë fazat e një procesi kërkimor dhe të njohin një sërë mjetesh për mbledhjen e të dhënave. • Shqyrtojnë në mënyrë kritike punimet kërkimore dhe identifikojnë procesin e kërkimit në një studim të botuar. • Bëjnë dallimin ndërmjet problemit, pyetjeve, hipotezave dhe objektivave të kërkimit. • Identifikojnë dhe zgjedhin dizajnin dhe metodologjinë e duhur të kërkimit për të hetuar një problem të zgjedhur kërkimor. • Vlerësojnë pikat e forta dhe kufizimet e dizajneve të ndryshme. • Interpretojnë të dhënat dhe rezultatet e një studimi. 						
Parakushte(t)		Jo				
LITERATURA						
Kërkohet:						
Cohen, L., Manion, L., & Morrison, K. R. (2011). Research methods in education (7th ed.). London: Routledge.						
Kumar, R. (2005). Research methodology: A step-by-step guide for beginners (2nd ed.). Los Angeles: SAGE.						
Matthews, B., & Ross, L. (2010). Metodatat e Hulumtimit. Udhezues praktik për shkencat sociale dhe humane. Tirane: CDC.						
Thomas, G. (2011). How to do your case study: A guide for students. London: Sage Publications.						

Rekomandohet:

Brown, V., & Clarke, V. (2013). Successful Qualitative Research: A Practical Guide for Beginners. London: Sage Publication.

Bryman, A. (2012). Social Research Methods (4th ed.). New York: Oxford University Press.

Chalmers, A. (1999). What is this thing called science? (3rd ed.). Indianapolis: Hackett Publishing.

David, S. (2013). Doing Qualitative Research: A Practical Handbook (4th ed.). London: SAGE Publications.

Lovitts, B. E., & Wert, E. L. (2009). Developing quality dissertations in the social sciences: A graduate student's guide to achieving excellence. Sterling, VA: Stylus.

Thomas, G. (2013). How to do your research project: A guide for students in education and applied social sciences (2nd ed.). London: Sage Publication.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Kombinimi i diskutimit të seminarit, metodave sokratike, diskutimit, pjesëmarrjes aktive, prezantimeve, rasteve studimore, vlerësimit të kërkimit aktual dhe një projekti kërkimor. Çdo student pritet të vijë në klasë pasi të ketë lexuar materialin e caktuar, i përgatitur për të diskutuar dhe ndërvepruar në mënyrë kritike me leximet dhe për të kontribuar në lëndë në mënyrë konceptuale, me aftësi, efektive dhe vlerësuese.

VLERËSIMI

Studime gjatë lëndës	Sasia	Përqindja e notës finale
Përgatitje për seminare duke iu referuar prezantimeve	4	30 %
Kuiz / Test		
Reflektime kritike në detyrat e rasteve studimore	4	30 %
Ese		
Punë laborator		
Detyra përfundimtare	1	30 %
Pjesëmarrje në leksion		10 %
Përqindja totale / Nota		100 %

Moduli B: Drejtim & Menaxhim

1. Komunikim Organizativ

Kodi	Lloji i lëndës	Semestri	Orët e kontaktit	Orët e vetë-studimit	Orët totale	Kredite (ECTS)
L ^{oo}	E detyrueshme	I / III	50	100	150	5
Lektor			Dr. Roy Atwood			
Gjuha			anglisht			
<p>Qëllimi i lëndës Kjo lëndë masteri studion teoritë, hulumtimet dhe praktikat e komunikimit në mjediset organizative. Çështjet e komunikimit organizativ dhe temat e mbuluara mund të ndryshojnë, por zakonisht përfshijnë rolin e komunikimit në lloje të ndryshme organizatash, proceset dhe performancën e tyre, të tilla si socializimi i të sapoardhurve, kultura organizative, ekologjia organizative, ndërlidhja menaxher-punonjës, marrëdhëniet ndërorganizative, menaxhimi i konflikteve, lidhshipi dhe ndjekësit, komunikimi në mjediset e punës në distancë, mediat dhe marrëdhëniet me publikun, si dhe teknologjitë e komunikimit organizativ.</p>						
<p>Rezultatet e të nxënësve Në fund të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikojnë dhe shpjegojnë përkufizime dhe qasje të ndryshme në fushën e komunikimit organizativ • Përshkruajnë disa nga konceptet kryesore të komunikimit brenda formave të ndryshme të organizimit dhe në kontekste të ndryshme të ekologjisë organizative • Identifikojnë dhe përshkruajnë teoritë kryesore të komunikimit organizativ • Tregojnë se si mund të përdoren qasje të ndryshme ndaj kulturës dhe komunikimit organizativ si një mjet analitik ose shpjegues • Identifikojnë dhe vlerësojnë në mënyrë kritike elementet e diskursit brenda dhe ndërmjet organizatave • Shpjegojnë implikimet e gjetjeve në kërkimin e komunikimit organizativ për mësimdhënien, mësimin, performancën e punës dhe menaxhimin në lloje të ndryshme organizatash • Identifikojnë dhe zbatojnë qasjet teorike dhe praktike për menaxhimin e konflikteve • Identifikojnë dhe zbatojnë qasjet kryesore për zgjidhjen e konflikteve 						
Parakusht(e)		Jo				

LITERATURA

Kërkohet:

McDonald, J., ed. (2019). *Movements in Organizational Communication Research*. Routledge.

Institute, A. (2015). *The anatomy of peace: Resolving the heart of conflict*. Oakland: Berrett-Koehler Publisher.

Putnam, L. and Mumby, D. (2014). *The SAGE Handbook of Organizational Communication: Advances in Theory, Research, and Methods*. 3rd Ed. SAGE Publications.

Rekomandohet:

Baum, J. and Shipilov, A. (2006). *Ecological Approaches to Organizations*. Ch. 2 in Clegg, et al., eds., *The SAGE Handbook of Organization Studies*. 2nd Ed. SAGE Publications.

Gillis, T., ed. (2006). *The IABC Handbook of Organizational Communication*. John Wiley & Sons.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Kombinim i leksionit, diskutimit, pjesëmarrjes aktive, prezantimeve të studentëve, rasteve studimore, shkrimit të eseve/detyrave. Kjo lëndë përfshin një kombinim të diskutimit, pjesëmarrjes aktive, rasteve studimore, punës në grupe të vogla dhe prezantimeve. Çdo student pritët të marrë pjesë në rastet studimore dhe situata me role dhe aktivitete dhe detyra të tjera në klasë.

VLERËSIMI

Studime gjatë lëndës	Sasia	Përqindja e notës finale
Detyra seminari	2	60 %
Prezantim	1	15%
Detyra përfundimtare	1	15%
Pjesëmarrje në leksion		10%
Përqindja totale / nota		100 %

2. Etika Profesionale

Kodi	Lloji i lëndës	Semestri	Orët e kontaktit	Orët e vetë-studimit	Orët totale	Kredite (ECTS)
L ^{oo}	E detyrueshme	I / III	50	100	150	5
Lektori			Prof. Dr. Harald Seubert / Dr. Roy Atwood			
Gjuha			anglisht			
<p>Qëllimi i lëndës</p> <p>Kjo lëndë ofron një përmbledhje të teorive dhe aplikimin e tyre në lidhshmëri dhe etikë profesionale. Ajo i prezanton studentët me njohuritë, aftësitë dhe parimet e nevojshme për të drejtuar në mënyrë etike në pozicione të ndryshme drejtuese brenda një sërë organizatash (biznes, arsim, jo-fitimprurëse, etj.). Studentët do të praktikojnë aftësi që u mundësojnë atyre të jenë drejtues efektivë organizativë dhe grupi si dhe profesionistë, të cilët janë të vetëdijshëm për rëndësinë e parimeve etike dhe zbatimin e tyre. Studentët do të marrin pjesë në aktivitetet e vetëvlerësimit dhe do të përdorin informacionin e rezultateve për t'u bërë liderë vërtet frymëzues dhe të besueshëm për të përmirësuar grupin, organizatën dhe veten e tyre profesionalisht.</p>						
<p>Rezultatet e të nxënësve</p> <p>Në fund të lëndës studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojnë dhe vlerësojnë modele të ndryshme të lidhshmërisë dhe menaxhimit, si dhe konceptet etike • Krahasojnë teoritë aktuale të lidhshmërisë etike dhe t'i zbatojnë ato në mënyrë të përshtatshme në mjediset profesionale • Rendisin dhe përshkruajnë konceptet etike dhe kriteret për qasjen e duhur • Analizojnë aftësitë dhe prirjet e kërkuara nga liderat dhe menaxherët si dhe ndërlidhjen e tyre • Identifikojnë dhe reflektojnë mbi rolin e etikës profesionale brenda institucioneve si dhe pikat e forta dhe të dobëta të saj • Njohin dhe vlerësojnë strategjitë e etikës profesionale • Shpjegojnë dhe kritikojnë një sërë modelesh etike të lidhshmërisë dhe menaxhimit në organizata/kultura të ndryshme • Mbrojnë kërkesat ligjore dhe etike për grupet dhe organizatat drejtuese • Kuptojnë (duke ditur dhe zbatuar në mënyrë të përshtatshme) parimet etike në marrëdhëniet dhe situatat komplekse me familjet, studentët, punonjësit, institucionet dhe aktorët e ndryshëm të komunitetit dhe publikut. 						
Parakusht(e)		Jo				
LITERATURA						
Kërkohet:						
Auden, W. H., Kallman, C., & Mendelson, E. (1993). Libretti and other dramatic writings: 1939-1973. Princeton, NJ: Princeton Univ. Press.						

Carter, S., MacDonald, N. J., & Cheng, D. C. (1997). Basic finance for marketers. Rome: FAO.

Collins, J., & Porras, J. I. (2004). Built to last: Successful habits of visionary companies. New York: Harper Business.

Covey, S. M., & Merrill, R. R. (2018). The speed of trust: The one thing that changes everything. New York: Free Press.

George, B., & Bennis, W. G. (2009). 7 lessons for leading in crisis. San Francisco: Jossey-Bass.

Kouzes, J. M., & Posner, B. Z. (2017). The leadership challenge Workbook Revised. New York NY: John Wiley & Sons.

Peter, T. J., & Waterman, R. H. (1995). In search of excellence: Lessons from America's best-run companies. London: HarperCollins Business.

Phillips, D. T. (2009). Lincoln on leadership: Executive strategies for tough times. New York, NY: Grand Central Publishing.

Pree, M. D. (2004). Leadership is an art. New York, NY: Currency.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Kombinimi i diskutimit të seminarit, sesioneve të grupeve të punës, pjesëmarrjes aktive, prezantimeve. Çdo student pritet të vijë në klasë pasi të ketë lexuar materialin e caktuar, i përgatitur për të diskutuar dhe ndërvepruar në mënyrë kritike me leximet dhe për të kontribuar në lëndë në mënyrë konceptuale, me aftësi, efektive dhe vlerësuese.

VLERËSIMI

Studime gjatë lëndës	Sasia	Përqindja e notës finale
Përgatitje për seminare duke iu referuar prezantimeve	1	20%
Detyra	1	40%
Diskutim	1	15%
Detyra finale	1	25%
Përqindja totale / nota		100 %

3. Burimet Njerëzore

Kodi	Lloji i lëndës	Semestri	Orët e kontaktit	Orët e vetë-studimit	Orët totale	Kredite (ECTS)
L ^{oo} 1464	E detyrueshme	II / IV	50	100	150	5
Lektor			Dr. Michael Savvas / Dr. (cand.) Renato Preza			
Gjuha			anglisht			
<p>Qëllimi i lëndës</p> <p>Kjo lëndë lidhet me natyrën dhe qëllimin e Burimeve Njerëzore (BNJ). Kjo lëndë fokusohet veçanërisht në natyrën e BNJ në organizata, funksionet dhe aktivitetet e duhura. Studentët do të njihen me teori të ndryshme organizative si dhe modele të ndryshme të BNJ në organizata p.sh. Modeli Fombrun, Tichy dhe Devanna, Modeli i Harvardit, Modeli Warwick dhe Modeli i Katesë, i cili do t'i udhëzojë studentët përmes aplikimit të modelit për të rritur efektivitetin organizativ. Në këtë lëndë studentët do të kenë mundësinë të kombinojnë teorinë dhe praktikën.</p>						
<p>Rezultatet e të nxënësve</p> <p>Në fund të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruajnë natyrën e burimeve njerëzore në organizatë • Identifikojnë se çfarë janë burimet njerëzore • Përcaktojnë menaxhimin • Përvijojnë aktivitetet e burimeve njerëzore • Shqyrtojnë funksionet e burimeve njerëzore • Bëjnë dallimin ndërmjet teorive të ndryshme organizative • Krahasojnë modelet e ndryshme të burimeve njerëzore me njëri-tjetrin • Zbatojnë metoda të menaxhimit të projektit në rastet studimore. 						
Parakusht(e)		Studentët duhet të kenë njohuri bazë të teorisë organizative. Ata kanë marrë njohuri mbi diferencimin, analizën dhe format specifike të strukturës dhe organizimit të procesit.				
<p>LITERATURA</p> <p>Kërkohet:</p> <p>Bohlander, G. W., & Snell, S. (2010). Managing human resources. Mason, OH: South-Western Cengage Learning</p> <p>Daft, R. L. (2010). Management. Mason, OH: South-Western Cengage Learning.</p> <p>Rekomandohet:</p> <p>Becker, & Brian/Huselid. (1997). HR as a source of shareholder value. Research and Recommendations. New Jersey: John Wiley & Sons</p>						

Stock-Homburg, R. (2010). Personalmanagement. Theorien - Konzepte - Instrumente. Wiesbaden.: Gabler

Ulrich, D. (1997). Measuring Human Resources. An overview of practice and a prescription for results. Hoboken, New Jersey: John Wiley & Sons

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Kombinimi i leksionit, diskutimit, pjesëmarrjes aktive, prezantimeve, rasteve studimore, shkrimit të eseve/detyrave.

VLERËSIMI

Studime gjatë lëndës	Sasia	Përqindja e notës finale
Prezantim	2	25 %
Kuiz / Test		
Projekte / detyra		
Detyrë kursi	1	50 %
Pjesëmarrje në leksion		25 %
Përqindja totale / Nota		100 %

4. Menaxhimi i Ndryshimeve

Kodi	Lloji i lëndës	Semestri	Orët e kontaktit	Orët e vetë-studimit	Orët totale	Kredite (ECTS)
L ^{oo}	E detyrueshme	II / IV	50	100	150	5
Lektor			Prof. Dr. Bardhyl Musai			
Gjuha			anglisht / shqip			
Qëllimi i lëndës						
<p>Kjo lëndë ofron një përmbledhje të teorive dhe kërkimeve në lidhshmëri dhe vlerësimin organizativ. Ajo i prezanton studentët me njohuritë, aftësitë, praktikat më të mira dhe kërkimin e nevojshëm për të drejtuar në mënyrë efektive në pozicione të ndryshme drejtuese brenda një sërë organizatash (biznes, arsim, jo-fitimprurëse, etj.). Studentët do të praktikojnë aftësi që u mundësojnë atyre të jenë drejtues dhe komunikues efektivë organizativë dhe grupi. Studentët do të marrin pjesë në rastet studimore, në aktivitetet e vlerësimit dhe do të përdorin informacionin e rezultateve për të drejtuar dhe ndjekur qëllimet strategjike për të përmirësuar grupin, organizatën dhe veten e tyre profesionalisht.</p>						
Rezultatet e të nxënësve						
<p>Në fund të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Identifikojnë se ku qëndron kompleksiteti i menaxhimit të ndryshimit dhe të marrin parasysh sfidat për të gjitha palët e përfshira në proces. • Shpjegojnë natyrën e rezistencës gjatë ndryshimit organizativ. • Përshkruajnë se si dhe pse ndodhin ndryshimet dhe pasojat e këtyre ndryshimeve për organizatat. • Zbatojnë dhe integrojnë konceptet themelore në një sërë situatash për ndryshim. • Përgatitin plane veprimi dhe procedura që inkurajojnë të gjithë aktorët të përfshihen në procesin e ndryshimit. • Analizojnë klimën organizative për ndryshime efektive dhe vendimmarrje të përgjegjshme. • Zhvillojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë një plan gjithëpërfshirës të zhvillimit profesional të projektuar për të adresuar fushat e identifikuara për ndryshim. • Vlerësojnë me sukses efektivitetin e lidhshmërisë brenda çdo konteksti. • Mendojnë për të menaxhuar në mënyrë kritike ndryshimin në mjedise të ndryshme organizative. 						
Parakusht (e)		Jo				
LITERATURA						
Kërkohet:						
Fullan, M. (2010). Kuptimi i ri i ndryshimit në arsim. Tiranë: CDE.						
Hayes, J. (2018). The theory and practice of change management. Basingstoke: Palgrave, Macmillan.						

Rekomandohet:

Fullan, M. G. (2001). Leading in a culture of change being effective in complex times. San Francisco, CA: Jossey-Bass.

Palmer, I., Dunford, R., & Akin, G. (2009). Managing organizational change: A multiple perspectives approach. Boston: McGraw-Hill Irwin.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Kombinimi i leksionit, diskutimit, pjesëmarrjes aktive, punimit/detyrave. Kjo lëndë do të përfshijë një kombinim të leksioneve, diskutimeve, pjesëmarrjes aktive, rasteve studimore, analizave dhe reflektimit kritik si dhe punës në grupe të vogla. Secili student do të inkurajohet të vijë në klasë i përgatitur për të mësuar, diskutuar, bashkëvepruar dhe shprehur pikëpamjet e tij.

VLERËSIMI

Studime gjatë lëndës	Sasia	Përqindja e notës finale
Prezantim	1	30%
Kuiz / Test		
Detyra	1	60%
Ese		
Puna laborator		
Detyra përfundimtare		
Pjesëmarrje në leksion		10%
Përqindja totale / Nota		100 %

5. Menaxhim Strategjik

Kodi	Lloji i lëndës	Semestri	Orët e kontaktit	Orët e vetë-studimit	Orët totale	Kredite (ECTS)
L ^o 1461	E detyrueshme	I / III	50	100	150	5
Lektor			Prof. Dr. Werner Esser			
Gjuha			anglisht			
E detyrueshme / Opsionale			E detyrueshme			
Qëllimi i lëndës						
<p>Qëllimi i lëndës është të zhvillojë njohuritë dhe të kuptuarit e proceseve në shumë nivele të përfshira në menaxhimin strategjik të organizatave dhe grupeve dhe individëve përbërës të tyre. Pjesëmarrësit do të njihen me teorinë më të avancuar rreth organizimit dhe menaxhimit dhe sesi procese të tilla lidhen me strategjinë. Lënda do të mbështesë zhvillimin e analizës së biznesit të studentëve dhe aftësive të vendimmarrjes strategjike dhe do t'i prezantojë studentët me konceptet e krijimit dhe menaxhimit të strategjisë veçanërisht në organizata. Lënda do të shërbejë si një platformë intelektuale për të vazhduar në lëndë të mëtejshme studimi.</p>						
Rezultatet e të nxënit						
<p>Në fund të kësaj lënde studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shqyrtojnë elementet kryesore të strategjisë duke përfshirë skanimin mjedisor, zhvillimin e skenarit, kompetencat kryesore dhe pozicionimin strategjik • Shqyrtojnë çështjet e përfshira në menaxhimin e burimeve njerëzore, dinamikën e grupit dhe komunikimin në organizata • Shqyrtojnë çështjet e njerëzve që lidhen me menaxhimin e projektit duke përfshirë liderhipin, konfliktin, negociimin, grupet e projektit, motivimin dhe shpërblimin • Shpjegojnë se si organizatat menaxhojnë rezistencën ndaj ndryshimit • Menaxhojnë aspektet financiare, të prokurimit dhe të riskut të projekteve • Analizojnë zgjidhjet strategjike për lloje të ndryshme organizatash dhe për kontekste të ndryshme organizative • Analizojnë natyrën e organizatave që mësojnë dhe menaxhojnë ndryshimet teknologjike. • Vlerësojnë çështjet e përfshira në ekzekutimin e strategjisë duke përfshirë shtrirjen organizative, stimujt dhe sistemet e matjes; strategjinë dhe kulturën, vlerat dhe etikën. • Vlerësojnë ndryshimet e planifikuara dhe modelet e ndryshimeve emergjente për menaxhimin e ndryshimeve në organizata • Vlerësojnë mjetet për analizën strategjike, për shembull, kurbën e përvojës, matricën e ndarjes së rritjes, modelet e porterit për analizën e industrisë, pozicionimin konkurrues dhe inovacionin e vlerës. • Rishikojnë natyrën, zbatimin dhe praktikën e Menaxhimit të Projektit dhe rolin e menaxherit të projektit 						
Parakusht (e)		Nëse po, specifiko të lutem				

LITERATURA

Körkohet:

Isaacs, W. (1999). *Dialogue and the art of thinking together*. New York: Currency.

Kaeufer, K., & Scharmer, O. (2013). *Leading from the Emerging Future: From Ego-System to Eco-System Economies*. Berrett-Koehler

Kirtman, L., & Fullan, M. (2016). *Leadership: Key competencies for whole-system change*. Bloomington, IN: Solution Tree Press.

Kleiner, A. (1994). *The fifth discipline field book: Strategies and tools for building a learning organization*. New York: Currency Doubleday.

Lave, J., & Wenger, E. (1991). *Situated learning: Legitimate peripheral participation*. Cambridge: Cambridge Univ. Pr.

Mintzberg, H. (1967). *The science of strategy-making; managerial methods and planner programs*. Charleston, South Carolina: Nadu Press.

Mintzberg, H. (1970). Structured Observation As A Method To Study Managerial Work. *Journal of Management Studies*, 7(1), 87-104. doi:10.1111/j.1467-6486.1970.tb00484.x

Mintzberg, H. (1979). Patterns in Strategy Formation. *International Studies of Management & Organization*, 9(3), 67-86. doi:10.1080/00208825.1979.11656272

Mintzberg, H. (1979). *The structuring of organizations: The synthesis of the research*. Englewood Cliffs, NJ: Prentice-Hall.

Mintzberg, H. (1987). *Crafting strategy*. Boston: Harvard Business Review Reprint Service.

Mintzberg, H. (1987). The Strategy Concept I: Five Ps for Strategy. *California Management Review*, 30(1), 11-24. doi:10.2307/41165263

Mintzberg, H. (1989). *Mintzberg on management inside our strange world of organizations*. New York: Free Press

Mintzberg, H. (1990). *The manager's job: Folklore and fact*. Boston, MA: Harvard Business Review.

Mintzberg, H. (1998). *Covert Leadership. Notes on Managing Professionals*. CA: Harvard Business Review.

Mintzberg, H. (2001). Managing Exceptionally. *Organization Science*, 12(6), 759-771. doi:10.1287/orsc.12.6.759.10081

Mintzberg, H. (2001). The yin and the yang of managing. *Organizational Dynamics*, 29(4), 306-312. doi:10.1016/s0090-2616(01)00035-3

Mintzberg, H. (2004). *Enough Leadership*. CA: Harvard Business Review.

Mintzberg, H., & Jorgensen, J. (1987). Emergent Strategy for Public Policy. Canadian Public Administration. Hoboken, New Jersey: John Wiley & Sons.

Mintzberg, H., & Mchugh, A. (1985). Strategy Formation in an Adhocracy. Administrative Science Quarterly, 30(2), 160. doi:10.2307/2393104

Mintzberg, H., & Waters, J. A. (1989). Of Strategies, Deliberate and Emergent. Readings in Strategic Management, 4-19. doi:10.1007/978-1-349-20317-8_1

Mintzberg, H., Ahlstrand, B., & Lampel, J. (2008). Strategy safari: A guided tour through the wilds of strategic management. Hemel Hempstead: Prentice Hall

Montgomery, C. A. (2012). The strategist: Putting leadership back into strategy. London: Collins.

Peter, B. G., Andrew, S., McLean, N., & Mayer, D. (2019). Discovering Your Authentic Leadership. California: Harvard Business Review.

PROSSER, J. (2003). Image-based research: A sourcebook for qualitative researchers. London: Routledge.

Scharmer, C. O., & Senge, P. (2016). Theory U: Leading from the Future as It Emerges. Oakland: Berrett-Koehler.

Senge, P. M. (1994). The fifth discipline: The art and practice of the learning organization. New York, NY: Doubleday Currency

Rekomandohet:

Bennis, W. G., & Thomas, R. J. (2007). Crucibles of Leadership. Leadership, 51-60. doi:10.2307/j.ctvpg85tk.9

George, B., McLean, A. N., & Craig, N. (2008). Finding your true north: A personal guide. San Francisco, CA: Jossey-Bass.

George, W. O., & Sims, P. (2007). True North: Discover your authentic leadership. San Francisco: Wiley.

Goleman, D. (2017). What Makes a Leader? Boston, MA: Harvard Business Review Press.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Kombinim i leksionit, diskutimit, pjesëmarrjes aktive, prezantimeve, rasteve studimore, shkrimit të eseve/detyrave.

VLERËSIMI

Studime gjatë lëndës	Sasia	Përqindja e notës finale
Prezantim	1	30 %
Kuiz / Test		
Projekti	1	30 %
Ese	1	40 %

Punë laboratori		
Detyrë kursi		
Pjesëmarrje në leksion		
Përqindja totale / nota		100 %

6. Sjellje Organizative

Kodi	Lloji i lëndës	Semestri	Orët e kontaktit	Orët e vetë-studimit	Orët totale	Kredite (ECTS)
L ^{oo}	E detyrueshme	II / IV	50	100	150	5
Lektor			David Fagan / Dr. (cand.) Renato Preza			
Gjuha			anglisht			
<p>Qëllimi i lëndës</p> <p>Sjellja Organizative është një fushë studimi ndërdisiplinore, e cila eksploron sjelljen individuale, në grup dhe organizative si dhe ndikimin e individëve, grupeve, organizatave dhe shoqërisë në krijimin, formësimin dhe kontrollin e sjelljeve. Pikëpamja menaxheriale kërkon të kuptojë sjelljen në mënyrë që të menaxhohet në mënyrë më efektive dhe etike. Këndvështrimi kritik kërkon të shikojë organizatën nga këndvështrimi i punonjësve dhe shtron pyetje në lidhje me ndikimin e praktikës menaxheriale dhe përvojën e tyre të punës më gjerësisht, duke përfshirë rolin që bashkëmoshatarët e tyre mund të luajnë në formësimin e përvojës së tyre të punës. Kjo lëndë ndërton dhe bazohet në përvojat tuaja personale të organizatave dhe institucioneve. Ju sfidon të përqafoji paqartësinë dhe ambivalencën: nuk ka përgjigje të mirëpërcaktuara për të kuptuar dhe menaxhuar sjelljen, gjë që e bën sjelljen, një fushë studimi kaq interesante dhe sfiduese dhe ju ndihmon si punonjës dhe menaxher të ardhshëm.</p>						
<p>Rezultatet e të nxënit</p> <p>Në fund të lëndës studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përcaktojnë parimet bazë të sjelljes organizative në tre nivele: individuale, në grup dhe organizative; • Shpjegojnë se si mjediset, qëndrimet dhe perceptimi ndikojnë në sjelljen në organizata; • Identifikojnë efektet e motivimit si mjet për përmirësimin e performancës së punës dhe efektivitetit organizativ; • Njohin elementet e sjelljes së grupit duke përfshirë identitetin, dinamikën e grupit dhe komunikimin, si ndikojnë këto në produktivitetin e vendit të punës; • Demonstrojnë një kuptim të dinamikës së grupeve dhe ndikimin e tyre në suksesin organizativ; • Njohin qasjet e ndryshme të lidershit dhe ndikimin e pushtetit dhe politikës në organizata; • Shpjegojnë se si të menaxhojnë në mënyrë efektive konfliktin dhe të zgjidhin konfliktin me të tjerët; • Identifikojnë karakteristikat e strukturës organizative dhe ndikimin e strukturave të ndryshme në sjelljen në vendin e punës; dhe • Shpjegojnë se si kultura organizative ndërton një mjedis pune kuptimplotë 						
Parakusht(e)		Jo				
LITERATURA						
Kërkohet:						

Greenberg, J., & Baron, R. J. (2000). Behavior in organization: Understanding and managing the human side of work. Upper Saddle River, NJ: Prentice Hall.

Kinicki, A., & Kreitner, R. (2007). Organizational behavior (7th ed.). Boston, Mass.: McGraw-Hill.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Studentët do të marrin pjesë në diskutime të seminarit, sesione të të mësuarit të përzier (online), vlerësime kritike të kërkimit aktual dhe praktikave më të mira dhe do të shkruajnë detyra me përmbajtje kritike mbi artikujt aktualë kërkimorë, leximin e pavarur dhe materiale të tjera të klasës.

VLERËSIMI

Studime gjatë lëndës	Sasia	Përqindja e notës finale
Përgatitje për seminare duke iu referuar prezantimeve		
Kuiz / Test		
Reflektime kritike mbi detyrat e rasteve studimore	1	40 %
Ese		
Punë laborator		
Detyra përfundimtare		
Prezantim në grup	1	50 %
Pjesëmarrje në leksion		10 %
Përqindja totale / Nota		100 %

7. Planifikim & Financë

Kodi	Lloji i lëndës	Semestri	Orët e kontaktit	Orët e vetë-studimit	Orët totale	Kredite (ECTS)
L ^{oo}	E detyrueshme	II / IV	50	100	150	5
Lektor			Dr. Peter Makiriyado			
Gjuha			anglisht			
<p>Qëllimi i lëndës</p> <p>Kjo lëndë shqyrton teorinë dhe praktikën e planifikimit dhe menaxhimit organizativ për organizatat publike dhe jo-fitimprurëse, bashkëpunimet dhe në një masë më të vogël, komunitetet. Lënda synon të theksojë të menduarit në kontekst se si të ndjekin qëllimet ose të arrihen qëllimet. Kjo përfshin gjithashtu të menduarit se çfarë është konteksti dhe si mund ose duhet të ndryshohet; cilat janë ose duhet të jenë qëllimet; dhe cilat aftësi ose kompetenca do të nevojiten ose mund të nevojiten dhe si mund të përdoren ato për të arritur qëllimet.</p>						
<p>Rezultatet e të nxënësve</p> <p>Kjo lëndë fokusohet në fuqizimin e studentëve për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruar procesin e identifikimit të objektivave të organizatës dhe formulimin e strategjive specifike për arritjen e tyre • Shpjeguar procesin e planifikimit në organizata në lidhje me personelin dhe shpërndarjen e burimeve. • Demonstruar të kuptuarit se çfarë duhet të merret parasysh gjatë procesit të planifikimit strategjik. • Përcaktuar dhe përshkruar planifikimin strategjik dhe qëllimin e tij të përgjithshëm. • Identifikuar faktorët e ndryshëm bazë që përcaktojnë shpërndarjen efektive të burimeve financiare. • Buxhetuar, të bërë kontabilitetin menaxherial dhe parashikuar dhe për të njohur rolin e tyre në strategjinë organizative. 						
Parakusht(e)		Jo				
<p>LITERATURA</p> <p>Kërkohet:</p> <p>Miller-Nobles, T. L., Mattison, B., & Matsumura, E. M. (2018). Horngren's financial & managerial accounting. Boston, MA: Pearson.</p> <p>Wehrich, H., Koontz, H., & Cannice, M. (2013). Management: A global, innovative, and entrepreneurial perspective. New Delhi: McGraw Hill Education (India) Private Limited.</p>						

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Kombinimi i diskutimit të seminarit, metodave sokratike, diskutimit, pjesëmarrjes aktive, prezantimeve, rasteve studimore, vlerësimit të kërkimit aktual dhe një projekti kërkimor. Çdo student pritët të vijë në klasë pasi të ketë lexuar materialin e caktuar, i përgatitur për të diskutuar dhe ndërvepruar në mënyrë kritike me leximet dhe për të kontribuar në lëndë në mënyrë konceptuale, me aftësi, efektive dhe vlerësuese.

VLERËSIMI

Studime gjatë lëndës	Sasia	Përqindja e notës finale
Diskutim		10 %
Test	1	10 %
Detyrë kursi	1	30 %
Provime	2	50 %
Përqindja total / Nota		100 %

8. Qeverisje & Zhvillim Organizativ

Kodi	Lloji i lëndës	Semestri	Orët e kontaktit	Orët e vetë-studimit	Orët totale	Kredite (ECTS)
L ^{oo}	E detyrueshme	I / III	50	100	150	5
Lektor			Dr. Roy Atwood			
Gjuha			anglisht			
<p>Qëllimi i lëndës</p> <p>Kjo lëndë pajis anëtarët e bordit drejtues, administratorët, drejtuesit e tjerë organizativë dhe studentët me kërkimet aktuale, teoritë dhe praktikat më të mira për qeverisjen dhe zhvillimin organizativ. Studentët do të shqyrtojnë literaturën aktuale mbi qeverisjen organizative, veçanërisht rolin e bordeve drejtuese dhe ballafaqojnë këto borde me menaxherët e tyre ekzekutivë. Qëllimi i lëndës është të rrisë ndërgjegjësimin kritik për teoritë dhe praktikat më të mira të qeverisjes për zhvillimin e organizatës. Studentët do të shqyrtojnë teoritë kryesore të qeverisjes (të tilla si teoritë e agjencisë, teoritë e varësisë nga burimet, teoritë e administrimit, teoritë e palëve të interesuara, teoritë e qeverisjes së politikave, teoritë e përfshirjes, etj.) dhe studimet e rasteve për mënyrën se si bordet mund të shmangin ose heqjen e autoritetit ose mikromenaxhimit të një organizate, duke ruajtur dhe arritjen e misionit, vlerave dhe qëllimeve organizative. Studentët do të shqyrtojnë gjithashtu se si bordet drejtuese mund të fuqizojnë drejtorin ekzekutiv të organizatës për të udhëhequr dhe për të arritur qëllimet dhe misionin e miratuar nga bordi i organizatës ose anasjelltas, ose ata bëhen pengesa për qëllimet dhe misionin e tyre. Studentët do të marrin pjesë në diskutime të seminarit, sesione të të mësuarit të përzier (online), vlerësime kritike të kërkimit aktual dhe praktikave më të mira dhe do të shkruajnë detyra me mendime kritike mbi artikujt aktualë kërkimorë, leximin e pavarur dhe materiale të tjera të klasës.</p>						
<p>Rezultatet e të nxënësve</p> <p>Në fund të lëndës studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkruajnë konceptet kryesore, teoritë dhe praktikat më të mira të qeverisjes dhe zhvillimit organizativ • Vlerësojnë hulumtimet aktuale mbi bordet drejtuese, zhvillimin organizativ si dhe lidhësit organizativ • Identifikojnë pengesat e përbashkëta dhe përmirësimet krijuese për bordet drejtuese efektive • Identifikojnë dhe adresojnë sfidat kryesore që lidhen me ndërveprimet e punës ndërmjet bordeve drejtuese dhe drejtuesve të tyre organizativë • Analizojnë dhe vlerësojnë modele të ndryshme të qeverisjes, lidhësit ekzekutiv dhe zhvillimit organizativ • Aplikojnë praktikat më të mira për problemet e studimit të rasteve dhe sfidat reale organizative • Zhvillojnë një "model të qeverisjes së politikave" në nivel bordi për lidhësit organizativ, planifikimin dhe zhvillimin strategjik dhe vlerësimin • Vlerësojnë në mënyrë kritike përvojën e vet organizative me bordet drejtuese, drejtuesit ekzekutivë dhe marrëdhëniet dhe arritjet e tyre të punës. 						
Parakusht(e)		Jo				
LITERATURA						
Kërkohet:						

Ansell, C., & Gash, A. (2007). Collaborative Governance in Theory and Practice. *Journal of Public Administration Research and Theory*, 18(4), 543-571. doi:10.1093/jopart/mum032

Carver, J., & Carver, M. M. (2009). *The policy governance model and the role of the board member*. San Francisco, CA: Jossey-Bass.

Eisenhardt, K. M. (1989). Making Fast Strategic Decisions In High-Velocity Environments. *Academy of Management Journal*, 32(3), 543-576. doi:10.5465/256434

Granovetter, M. (2010). *Getting a job: A study of contacts and careers*. Chicago: Univ. of Chicago Press.

Koufopoulos, D. N., Georgakakis, D. G., & Gkliatis, I. P. (2009). Board and organisational performance in healthcare non-profit public organisations: The Greek perspective. *International Journal of Business Governance and Ethics*, 4(4), 330. doi:10.1504/ijbge.2009.023787

Sundaramurthy, C., & Lewis, M. (2003). Control and Collaboration: Paradoxes of Governance. *The Academy of Management Review*, 28(3), 397. doi:10.2307/30040729

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Kombinimi i diskutimit të seminarit, metodave sokratike, diskutimit, pjesëmarrjes aktive, prezantimeve, rasteve studimore, vlerësimit të kërkimit aktual dhe një projekti kërkimor. Çdo student pritët të vijë në klasë pasi të ketë lexuar materialin e caktuar, i përgatitur për të diskutuar dhe ndërvepruar në mënyrë kritike me leximet dhe për të kontribuar në lëndë në mënyrë konceptuale, me aftësi, efektive dhe vlerësuese.

VLERËSIMI

Studime gjatë lëndës	Sasia	Përqindja e notës finale
Përgatitje për seminare duke iu referuar prezantimeve	4	30 %
Kuiz / Test		
Reflektime kritike mbi detyrat e rasteve studimore	4	30 %
Ese		
Punë laborator		
Detyra përfundimtare	1	30 %
Pjesëmarrje në leksion		10 %
Përqindja totale / Nota		100 %

Moduli C: Efektiviteti Organizativ

1. Menaxhim i Cilësisë

Kodi	Lloji i lëndës	Semestri	Orët e kontaktit	Orët e vetë-studimit	Orët totale	Kredite (ECTS)
L° 1465	E detyrueshme	II / IV	50	100	150	5
Lektor			Dr. Roy Atwood, Prof. Dr. Ulli Arnold			
Gjuha			anglisht			
E detyrueshme / Fakultative			E detyrueshme			
Qëllim i lëndë Cilësia është një faktor kyç suksesi për çdo kompani shërbimi dhe prodhimi. Kjo lëndë ofron qasje holistike, të bazuara shkencërisht për menaxhimin e cilësisë, të cilat janë të orientuara drejt proceseve të menaxhimit dhe fazave të analizës, planifikimit, menaxhimit dhe kontrollit. Pjesët thelbësore të lëndës përfshijnë procedurat për matjen e cilësisë, instrumentet për kontrollin e cilësisë dhe menaxhimin e pritjeve, zbatimin e qasjeve të Menaxhimit të Cilësisë duke përdorur standardet ISO 9000 dhe modelin EFQM/TQM.						
Rezultatet e të nxënit Në fund të lëndës studentët do të jenë në gjendje të: <ul style="list-style-type: none">• Dallojnë qasjet e Menaxhimit të Cilësisë dhe të tregojnë avantazhet dhe disavantazhet e saj• Aplikojnë instrumentet e sigurimit të cilësisë që janë të përshtatshme për qasjet e zgjedhura të Menaxhimit të Cilësisë• Vlerësojnë pikat e forta dhe të dobëta të ndryshme. Qasjet dhe kornizat• Masin performancën organizative duke përdorur mjetet: EFQM, Performancën Prism, Mënyrën SMART Piramid si dhe qasjet e lidhura me klientët• Integrojnë mekanizmat e planit dhe kontrollit për qasjet e menaxhimit të cilësisë• Zbatojnë një sistem të menaxhimit të cilësisë të përshtatur me nevojat e organizatës• Hartojnë analizën, planifikimin, zbatimin dhe kontrollin e mbështetjes dhe koordinimit të aktiviteteve që lidhen me cilësinë						

LITERATURA

Kërkohet:

Tague, N. (2013). The Quality Toolbox, 2nd edition. Wisconsin: ASQ Quality Press.

Rekomandohet:

Cameron, K. S., & Quinn, R. E. (2011). Diagnosing and changing organizational culture: Based on the competing values framework. San Francisco, CA: Jossey-Bass.

Diefenbach, T., & Sillince, J. A. (2011). Formal and Informal Hierarchy in Different Types of Organization. *Organization Studies*, 32(11), 1515-1537. doi:10.1177/0170840611421254

G., M. I., & Ray, R. C. (2009). *The road to results: Designing and conducting effective development evaluations*. Washington: The World Bank.

Geser, H. (2002). *Organizations as Social Actors*. Switzerland: Geser.net.

Kettunen, H. A. (2008). *A conceptual framework to help evaluate the quality of institutional performance*. Finland: Turku University of Applied Sciences.

Luhmann, N., Baecker, D., & Gilgen, P. (2013). *Introduction to Systems Theory*. Cambridge: Polity Press.

March, J. G., Miller, C. C., Grewal, R., Robson, M. J., Schwab, A., & Prietula, J. M. (1997). *Crossroads-Organizational Performance as a Dependent Variable*. Catonsville: The Institute for Operations Research and the Management Sciences.

Mayer, W. (2002). *Sociological Theory and Evaluation Research: An Application of its Usability for Evaluating Sustainable Development*. Saarbrücken: Centrum für Evaluation.

McAuley, J., Duberley, J., & Johnson, P. (2014). *Organization theory: Challenges and perspectives*. Harlow: Pearson Education Limited.

Modell, S. (2004). *Performance Measurement Myths in the Public Sector. A Research Note*. New Jersey, Wiley Online Library.

Spence, J. T., Darley, J. M., & Foss, D. J. (1998). *Annual review of psychology*. Palo Alto, CA: Annual Reviews.

Scotter, J. R., & Motowidlo, S. J. (1996). Interpersonal facilitation and job dedication as separate facets of contextual performance. *Journal of Applied Psychology*, 81(5), 525-531. doi:10.1037/0021-9010.81.5.525

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

Kombinimi i literaturës, diskutimit, pjesëmarrjes aktive, prezantimeve. Studentëve do t'u kërkohet të vlerësojnë performancën e tyre pas çdo prezantimi si dhe të vlerësojnë studentët e tjerë.

VLERËSIMI

Studime gjatë lëndës	Sasia	Përqindja e notës finale
Prezantim në grup	1	30 %
Provim me shkrim		
Projekt / detyra		
Ese		
Punë laborator		
Detyrë kursi	1	60 %
Pjesëmarrje në leksion		10 %
Përqindja totale / Nota		100 %

2. Menaxhimi i Performancës

Kodi	Lloji i lëndës	Semestri	Orët e kontaktit	Orët e vetë-studimit	Orët totale	Kredite (ECTS)
L ^{oo}	E detyrueshme	I / III	50	100	150	5
Lektor			Dr. Peter Makiriyado			
Gjuha			anglisht			
Qëllimi i lëndës						
<p>Kjo lëndë shqyrton natyrën dhe rëndësinë e një sistemi efektiv të menaxhimit të performancës për të ndihmuar organizatat të përcaktojnë dhe të arrijnë qëllimet afatshkurtra dhe afatgjata. Lënda synon të përforcojë menaxhimin e performancës si një proces i vazhdueshëm i planifikimit, lehtësimit, vlerësimit dhe përmirësimit të performancës individuale dhe organizative. Përveç kësaj, lënda thekson rëndësinë e matjes së efektivitetit të aktiviteteve të burimeve njerëzore që janë krijuar për të rritur performancën individuale dhe organizative.</p>						
Rezultatet e të nxënësve						
<p>Në fund të lëndës studentët do të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shpjegojnë konceptin e menaxhimit të performancës. • Kujtojnë menaxhimin e performancës si një proces të përhershëm që përfshin komponentët e ndërlidhur të kushteve paraprake, planifikimin e performancës, ekzekutimin e performancës, vlerësimin e performancës, rishikimin e performancës si dhe rinovimin dhe rikonstruktimin e performancës. • Përcaktojnë dhe përshkruajnë planifikimin strategjik dhe qëllimin e tij të përgjithshëm. • Identifikojnë faktorët e ndryshëm që përcaktojnë performancën duke përfshirë njohuritë deklarative, njohuritë procedurale dhe motivimin. • Miratojnë një qasje rezultatesh për matjen e performancës duke përfshirë zhvillimin e përgjegjësi, objektivave dhe standardeve. 						
Parakusht(e)		Jo				
LITERATURA						
Kërkohet:						
Aguinis, H., Forcum, L. E., & Joo, H. (2013). Using Market Basket Analysis in Management Research. California: Southern Management Association.						
Rekomandohet:						
Merchant, K. A., & A., V. D. (2017). Management control systems: Performance measurement, evaluation and incentives. Harlow, England: Financial Times Prentice Hall.						

Niven, P. R. (2002). Balanced scorecard step by step: Performance and maintaining results. New York: Wiley.

METODOLOGJIA E MËSIMDHËNIES

